

**Partia Euroatlantike e Kosovës**

**STATUTI I PARTISË EUROATLANTIKE TË KOSOVËS**

**Prishtinë,  
korrik 2019**

---

# I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

## Neni 1

Me këtë Statut, Partia Euroatlantike e Kosovës (në vijim: PEK) përcakton dhe rregullon emrin, emblemën, selinë, përfaqësimin, anëtarësinë, të drejtat dhe përgjegjësitë, format e organizimit dhe të veprimtarisë, procedurat për zgjedhje, forumet e saj, administratën, financimin, kushtet për ndërprerjen e veprimtarisë, rregulloret, si dhe çështjet e tjera me interes për anëtarët e saj.

## Neni 2

1. PEK-u është parti politike e anëtarëve të lirë dhe të përgjegjshëm, të cilët veprojnë mbi bazë të Statutit, për të arritur objektivat e përcaktuara në Programin e saj politik.

2. PEK-u si parti politike me të gjithë anëtarët e saj, si qëllim ka të respektojë dhe mbrojë:

- lirinë dhe demokracinë;
- ndërtimin e shtetit të së drejtës, demokratik e social, që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dinjitetin dhe personalitetin njerëzor, si dhe prosperitetin e të gjithë qytetarëve;
- vlerat themelore të familjes tradicionale në shoqëri;
- shenjtërinë e pronës private;
- humanizimin e solidaritetin shoqëror dhe frymën e tolerancës e të bashkëjetesës fetare;
- aspiratën për integrimin e plotë europian të Kosovës, nëpërmjet jetësimit të dëshirës së përhershme;
- drejtësinë, paqen, harmoninë dhe bashkëpunimin ndërmjet kombeve, si vlerat më të larta të njerëzimit.

## Neni 3

1. Për realizimin e synimeve themelore të saj, PEK-u shfrytëzon të gjitha mjetet demokratike parlamentare dhe joparlamentare.

2. PEK-u bashkëpunon me parti dhe organizime të tjera politike dhe jopolitike, si në vend ashtu edhe jashtë vendit.

## Neni 4

1. PEK-u vepron në mënyrë të pavarur dhe publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

2. PEK-u organizohet dhe vepron edhe jashtë Republikës së Kosovës, në përputhshmëri me ligjet e shteteve përkatëse.

3. Selia e PEK-ut është në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinë.

## Neni 5

1. PEK-u ka vulën, simbolin, flamurin dhe ditën e Partisë.

2. Formën dhe përmbajtjen e vulës, simbolit dhe flamurit të PEK-ut e përcakton Kryesia, si dhe mënyrën e përdorimit të tyre e përcakton Kryesia me vendim të veçantë.

3. Dita e Partisë Euroatlantike të Kosovës është 29 Qershori.

## Neni 6

---

1. PEK-un e përfaqëson Kryetari i Partisë Euroatlantike të Kosovës.
2. Në mungesë të Kryetarit, PEK-un e përfaqësojnë nënkryetarët, Sekretari i Përgjithshëm dhe anëtarët e Kryesisë, me autorizimin e Kryetarit.

## **II. ANËTARËSIA**

### **Neni 7**

1. Anëtar i PEK-ut mund të bëhet çdo qytetar i Kosovës, pa dallim race, kombësie, feje, gjinie, gjendje ekonomike dhe përkatësie shoqërore, i cili ka të drejtë vote.
2. Anëtarësimi bëhet me deklaram të lirë, në formë të shkruar, në nëndegë, në degë, në selinë qendërore të PEK-ut, si dhe në formë elektronike në faqen web të PEK-ut.
3. Regjistrin e anëtarëve të PEK-ut e mbajnë degët e PEK-ut dhe Kryesia e PEK-ut në formë elektronike dhe shkresore, i cili përmbanë të dhënat e përditësuara për të gjithë anëtarët e regjistruan në Partinë Euroatlantike.
4. Mbajtja e regjistrit dhe mënyra e lëshimit të kartelave për anëtarësinë rregullohet me rregullore të veçantë.

### **Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të PEK-ut**

### **Neni 8**

1. Anëtari i PEK-ut ka të drejtë:

- Të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organet e PEK-ut;
- Të marrë pjesë në aktivitetet e PEK-ut në mënyrë të barabartë;
- Të shprehë lirshëm mendimet brenda organeve të PEK-ut;
- Të japë propozime dhe të ofrojë nisma që janë në përputhshmëri me këtë Statut, si dhe me Programin dhe qëndrimet themelore politike të PEK-ut dhe të marrë pjesë në ndërtimin dhe realizimin e politikave të PEK-u;
- Të jetë i informuar për aktivitetet e PEK-ut, si dhe të gëzojë edhe të drejta të tjera të parapara me Statut.

2. Anëtari i PEK-ut ka për detyrë:

- T'i përmbahet Programit dhe Statutit të PEK-ut;
  - T'u përmbahet vendimeve dhe synimeve programore të PEK-ut;
  - Të ruajë nderin, autoritetin dhe interesat e PEK-ut;
  - Të përpiqet për suksesin e PEK-ut në fushata zgjedhore;
-

- Të paguajë anëtarësinë dhe të përmbushë detyrimet e tjera në përputhshmëri me Statutin dhe dokumentet e tjera.

### **Neni 9**

Kriter i vlerave në PEK është kontributi dhe përkushtimi i çdo anëtari dhe organi të saj në rritjen e anëtarësisë dhe të votave në të gjitha nivelet.

### **Neni 10**

1. Anëtarët e PEK-ut paguajnë anëtarësinë, shuma e të cilës është dymbëdhjetë (12) euro për anëtar brenda një viti kalendarik .
2. Askush nuk mund të realizojë të drejta shtesë në PEK përmes dhurimit të donacioneve financiare.
3. Anëtarët e regjistruar të PEK-ut dhe çdo zyrtar tjetër i saj, nuk janë përgjegjës për borxhet e PEK-ut.

### **Përfundimi i anëtarësisë**

### **Neni 11**

Anëtarësimi në PEK përfundon kur:

- *anëtari vdes;*
- *largohet nga anëtarësia me kërkesën e tij;*
- *anëtarsohet në një subjekt tjetër politik;*
- *kandidon në listën e ndonjë subjekti tjetër politik apo si kandidat i pavarur;*
- *përfundon nga PEK-u.*

### **Neni 12**

Çdo anëtari i PEK-ut mund të largohet me vullnetin e tij, duke njoftuar degën ku bën pjesë ose organin ku është zgjedhur. Me kërkesën e tij, mund t'i lëshohet vendimi me shkrim.

### **Përgjegjësitë e anëtarëve**

### **Neni 13**

1. Ndaj anëtarit të PEK-ut, i cili vepron kundër Programit dhe Statutit të PEK-ut, kundër vendimeve dhe qëndrimeve të organeve të PEK-ut, në të gjitha shkallët e organizimit, i cili me sjelljet e tij i dëmton interesat e PEK-ut, mund të shqiptohen masa disiplinore.
2. Zhvillimin e procedurës disiplinore, shkallën e përgjegjësisë dhe shqiptimin e masës disiplinore e bën Komisioni Disiplinor, i caktuar nga Kryesia e PEK-ut.

### **Neni 14**

1. Largimi i anëtarit nga PEK-u mund të bëhet në rast se:
-

- *Abuzon me vlerat themelore dhe objektivat e PEK-ut;*
- *Kryen veprime të cilat e sjellin PEK-un në situatë të palakmueshme apo diskredituese;*
- *Vepron kundër kandidatëve të PEK-ut në zgjedhjet parlamentare, lokale apo në nivele të tjera;*
- *I përkrah subjektet e tjera politike dhe kandidatët e tyre në zgjedhje.*

2. Anëtarët e PEK-ut nuk mund të jenë në pozita, në organe dhe forume të PEK-ut, nëse ata publikisht i refuzojnë dhe i mohojnë vendimet e organeve dhe forumeve anëtarë të të cilëve janë.

3. Vendimin për shqiptimin e masave disiplinore e merr Komisioni Disiplinor.

4. Anëtari i PEK-ut ka të drejtë ankese ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor në shkallën e dytë në Këshillin e Përgjithshëm.

5. Vendimi i Këshillit të Përgjithshëm është përfundimtar.

6. Procedurat për marrjen e vendimeve nga Komisioni Disiplinor dhe Këshilli i Përgjithshëm për shqiptimin e masave disiplinore apo largimin nga PEK-u, përcaktohen me rregullore të veçantë, të cilën e miraton Këshilli i Përgjithshëm me propozimin e Komisionit Statutar.

### **III. ORGANIZIMI DHE ORGANET E PEK-ut**

#### **Neni 15**

1. PEK-u është e organizuar në parimin territorial.
2. PEK-u organizohet në Degë dhe Nëndegë.
3. PEK-u bashkëpunon me anëtarët, përkrahësit dhe simpatizantët e vet edhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, si dhe me organizatat e themeluara në shtetet e tjera, në pajtim me rendin juridik të këtyre shteteve.
4. PEK-u mund të bashkëpunojë dhe të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare politike të cilat kanë aspiratë programore të ngjashme.

#### **Neni 16**

1. PEK-u ka organet dhe komisionet e saj.
  2. Organet e Partisë Euroatlantike të Kosovës janë:
    - 2.1. *Kuvendi i PEK-ut;*
    - 2.2. *Këshilli i Përgjithshëm i PEK-ut;*
    - 2.3. *Kryetari i PEK-ut;*
    - 2.4. *Kryesia e PEK-ut.*
  3. Komisionet e PEK-ut janë:
-

3.1. Komisioni Statutar;

3.2. Komisioni Mbikëqyrës;

3.3. Komisioni Disiplinor.

## **Kuvendi i PEK-ut**

### **Neni 17**

1. Kuvendi është organi më i lartë i PEK-ut.
2. Kuvendi mund të jetë Zgjedhor dhe Kuvend Pune.
3. Kuvendi zgjedhor është kuvend i rregullt dhe thirret çdo katër (4) vjet.
4. Kuvendi i Punës organizohet sipas nevojës ose së paku një herë ndërmjet dy kuvendeve zgjedhore.
5. Kuvendin e PEK-ut e thërret Kryetari i PEK-ut.
6. Kuvendi i PEK-ut thirret edhe atëherë kur këtë e kërkon 1/3 (një e treta) e delegatëve që e përbëjnë Kuvendin.
7. Kuvendi i thirrur sipas paragrafit paraprak mbahet në afatin prej 45 ditësh nga dita kur është shtruar kërkesa me shkrim.

### **Neni 18**

1. Kuvendin e PEK-ut e përbëjnë delegatët të zgjedhur në kuvendet e degëve.
2. Për numrin e delegatëve sipas degëve dhe kriteret e zgjedhjes së tyre vendos Këshilli i Përgjithshëm, përkatësisht Kryesia e PEK-ut, në bazë të autorizimit të Këshillit të Përgjithshëm.
3. Me rastin e zgjedhjes së delegatëve për Kuvend, secila degë siguron përfaqësimin e femrave dhe të rinjve.
4. Në punën e Kuvendit marrin pjesë edhe anëtarët aktualë të Kryesisë dhe të Këshillit të Përgjithshëm të PEK-ut, por pa të drejtë vote, nëse nuk janë të zgjedhur delegatë të Kuvendit përkatës.

### **Neni 19**

Kuvendi i PEK-ut:

- Miraton, ndryshon dhe plotëson Programin dhe Statutin e PEK-ut;

- Përcakton orientimet themelore të veprimit politik të PEK-ut;

- Nxjerrë rezoluta, deklarata dhe merr vendime;

- Zgjedh Kryetarin e PEK-ut;

- Zgjedh Këshillin e Përgjithshëm të PEK-ut;

---

- Zgjedh anëtarët e Komisionit Statutar, me propozim të Kryesisë;
- Shqyrton dhe vlerëson punën e organeve të PEK-ut;
- Vendos edhe për çështje të tjera në pajtim me Programin dhe Statutin e PEK-ut.

### **Neni 20**

1. Vendimet e Kuvendit janë të plotfuqishme në qoftë se në mbledhje marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit dhe nëse për to votojnë shumica e të pranishmëve.
2. Vendimet në Kuvend merren me votim të hapur.

### **Neni 21**

1. Zgjedhja e organeve të PEK-ut bëhet me votim të fshehtë.
2. Vendimet e organeve të PEK-ut konsiderohen të vlefshme nëse në mbledhjen e këtyre organeve: Kuvendit, Këshillit të Përgjithshëm, Kryesisë, Kuvendit të degëve, Kryesive të degëve, dhe nëndegëve marrin pjesë shumica e anëtarëve të këtyre organeve dhe votojnë shumica e anëtarëve të pranishëm.
3. Vendimi sipas paragrafit 2 të këtij neni nuk vlen për shpërbërjen e PEK-ut.

### **Këshilli i Përgjithshëm**

#### **Neni 22**

1. Këshilli i Përgjithshëm është organi më i lartë i PEK-ut.
2. Këshillin e Përgjithshëm e zgjedh Kuvendi i PEK-ut.

#### **Neni 23**

1. Këshillin e Përgjithshëm e përbëjnë 21 anëtarë.
2. Në Kuvendin Zgjedhor të PEK-ut zgjidhen anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm.
3. Kryetari i zgjedhur nga Kuvendi i PEK-ut është anëtar dhe Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm.
4. Komisioni kandidues i PEK-ut, në konsultim me Kryetarin, e bën propozimin e listës iniciale për përbërjen e Këshillit të Përgjithshëm.
5. Lista e iniciuar nga Komisioni Kandidues, në konsultim me Kryetarin e PEK-ut, mund të plotësohet edhe me kandidatë të tjerë nga ana e Kuvendit, por jo më shumë se 1/3 e numrit të përgjithshëm.
6. Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm mund të rizgjidhen.
7. Në punën e Këshillit të përgjithshëm marrin pjesë, pa të drejtë vote, deputetët, ministrat, kryetarët e komunave nga radhët e PEK-ut, kryetarët e degëve të PEK-ut, kryetarët e forumeve të PEK-ut dhe të Këshillit të Ekspertëve të PEK-ut, të cilët nuk janë anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm.

#### **Neni 24**

---

## 1. Këshilli i Përgjithshëm:

- *I propozon për miratim Kuvendit të PEK-ut Programin dhe Statutin e PEK-ut;*
- *Përcakton qëndrimet e PEK-ut bazuar në orientimet kryesore politike të PEK-ut dhe organeve të saj;*
- *Kujdeset për realizimin e vendimeve të Kuvendit të PEK-ut;*
- *Vendos për koalicionet para dhe pas zgjedhore në nivel qendror;*
- *Me propozim të Kryetarit zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Kryesisë, nënkryetarët dhe Sekretarin e Përgjithshëm;*
- *Me propozim të Kryesisë së PEK-ut, përcakton Kandidatin për President dhe për Kryeministër nga radhët e PEK-ut;*
- *Në bazë të listës iniciale të degëve, pas propozimit të Kryesisë, përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të PEK-ut për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- *Me propozim të kandidatit për kryeministër, miraton anëtarët e kabinetit qeveritar;*
- *Merr vendim për zgjedhjet në PEK;*
- *Vendos për pjesëmarrje të PEK-ut në qeverisjen qendrore;*
- *Vendos për anëtarësim në organizatat vendore dhe ndërkombëtare;*
- *Përcjell realizimin e politikës së PEK-ut nga ana e përfaqësuesve të saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në organet e tjera të pushtetit;*
- *Zgjedh Komisionin mbikëqyrës me propozim të Kryesisë;*
- *Shqyrton dhe miraton raportin mbi punën e Kryesisë së PEK-ut;*
- *Shqyrton dhe miraton raportin zgjedhor;*
- *Me propozim të Kryesisë miraton rregulloret e parapara me këtë Statut;*
- *Shqyrton dhe miraton planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të PEK-ut.*

2. Në rast se lidh koalicione me subjektet e tjera politike, PEK-u do ta ruajë identitetin dhe subjektivitetin e saj.

## **Kryetari i PEK-ut**

### **Neni 25**

1. Kryetari i PEK-ut zgjidhet në Kuvendin e PEK-ut, me votim të fshehtë, me më shumë kandidatë.
  2. Kandidimi për kryetar bëhet në Kuvend. Kandidatura miratohet me 50 për qind plus 1 të delegatëve të pranishëm.
-



3. Kryetari i PEK-ut njëkohësisht është kryetar i Kuvendit, i Këshillit të Përgjithshëm dhe i Kryesisë së PEK-ut.

## **Neni 26**

Kryetari i PEK-ut:

- Përfaqëson PEK-un në përputhje me Statutin dhe Programin e PEK-ut, në vend dhe jashtë vendit;
- E udhëheq punën e PEK-ut dhe të organeve të saj;
- Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit të PEK-ut, të Këshillit të Përgjithshëm dhe të Kryesisë së PEK-ut;
- Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit;
- Merr vendime dhe qëndrime politike në pajtim me Programin dhe Statutin e PEK-ut;
- Emëron zëdhënësin e PEK-ut;
- Emëron udhëheqësit në administratën e PEK-ut;
- Jep iniciativa për zgjedhje kuadrosh;
- Organizon takime të rregullta dhe të jashtëzakonshme me kryetarët e degëve;
- Mund të thërrasë mbledhjen e secilit organ apo trup të PEK-ut.

## **Neni 27**

1. Për punën e tij, Kryetari i përgjigjet Kuvendit të PEK-ut. Me propozimin e 1/3 së anëtarëve të Kuvendit, mund të ngrihet çështja e votëbesimit të Kryetarit. Votimin për besim mund ta ngrejë edhe vetë Kryetari.
2. Me votim për shkarkim, në përputhje me nenin 21, pushon mandati i Kryetarit të PEK-ut.
3. Kryetari mund të japë dorëheqje para skadimit të mandatit.
4. Në rast të paragrafit 2 dhe 3 të nenit 27, duhet të thirret Kuvendi i PEK-ut, në afatin prej 45 ditësh nga shpallja e mosbesimit apo nga dita e dorëheqjes.

## **Kryesia**

### **Neni 28**

1. Kryesia është organ politiko - ekzekutiv i Këshillit të Përgjithshëm të PEK-ut.
2. Kryesia përbëhet prej 21 anëtarëve.

### **Neni 29**

1. Kryesinë e zgjedh Këshilli i Përgjithshëm i PEK-ut.
-

2. Kryetari i PEK-ut i propozon Këshillit të Përgjithshëm listën prej 21 anëtarëve të Kryesisë.
3. Kryetari i PEK-ut, Kryetarja e Forumit të Gruas dhe Kryetari i Forumit të Rinisë janë anëtarë të Kryesisë.
4. Zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë bëhet sipas dispozitave të përcaktuara me nenin 21 të këtij Statuti.
5. Në bazë të propozimit të Kryetarit të PEK-ut, Këshilli i Përgjithshëm, nga radhët e anëtarëve të Kryesisë, zgjedh tre nënkryetarë dhe Sekretarin e Përgjithshëm të PEK-ut.
6. Këshilli i Përgjithshëm mund të zgjerojë listën e kandidatëve për Kryesinë e PEK-ut me propozime deri në 1/3 e përbërjes së saj.

### **Neni 30**

Kryesia e PEK-ut:

- Merr vendime politike dhe vendime të tjera, po qe se ato nuk janë në kompetencë të organeve të tjera të PEK-ut;
  - Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit, Këshillit të Përgjithshëm, Kryetarit dhe vendimeve të veta;
  - Kujdeset për bashkërenditjen e punëve të degëve dhe të nëndegëve, përcjell realizimin e vendimeve të organeve të PEK-ut, merr vendime konkrete lidhur me organizimin dhe funksionimin e tyre;
  - Zgjedh anëtarët e Komisionit Disiplinor;
  - I propozon Këshillit të Përgjithshëm themelimin e degëve të reja për vendbanime të caktuara;
  - Emëron Kryetarin e Grupit Parlamentar;
  - Shqyrton dhe aprovon propozimet e Kryesive të degëve për kandidat për Kryetar të Komunave;
  - Vendos për koalicione para dhe paszgjedhore në nivel lokal;
  - Përcjell, analizon dhe përkrahë punën e organeve të PEK-ut në terren dhe propozon masat përkatëse;
  - Në raste të veçanta, pezullon punën e Kryesisë së Degës, Nëndegës, forumeve dhe Këshillave deri në vendimin përfundimtar të Këshillit të Përgjithshëm dhe thërret Kuvendin e Degës, Nëndegës dhe organet e forumeve dhe këshillave;
  - Me vendim të veçantë përcakton mënyrën e përdorimit të vulës, logos dhe flamurit të PEK-ut;
  - Zgjedh udhëheqësin e Fondacionit me propozim të Kryetarit;
  - Përgatit dhe i propozon Këshillit të Përgjithshëm Programin dhe Statutin e PEK-ut;
  - I paraqet Raport Vjetor të Punës Këshillit të Përgjithshëm;
  - Qeveris pasurinë e PEK-ut dhe i paraqet Raport Financiar një herë në vit Këshillit të Përgjithshëm;
-

- *Vendos për dhënie të falënderimeve dhe të mirënjohjeve për merita e rezultate të punës;*

- *Kryen edhe punë të tjera në pajtim me Programin dhe me Statutin e PEK-ut.*

### **Neni 31**

1. Punën e Kryesisë e drejton Kryetari i PEK-ut.

2. Nënkryetarët ose Sekretari i Përgjithshëm e zëvendësojnë Kryetarin e PEK-ut në rast të mungesës së tij ose sipas autorizimit.

3. Kryesia e PEK-ut ka zëdhënësin, të cilin e emëron Kryetari i PEK-ut.

### **Neni 32**

1. Kryetari i PEK-ut, përkatësisht Kryesia, kanë të drejtë të pezullojnë ekzekutimin e vendimeve të organeve të PEK-ut, të cilat janë në kundërshtim me Ligjin, me Programin dhe Statutin e PEK-ut, si dhe me vendimet e tjera të PEK-ut.

2. Në rastet e tilla janë të detyruar që menjëherë ta njoftojnë Këshillin e Përgjithshëm, për të marrë vendim përfundimtar.

### **Komisioni Statutar**

#### **Neni 33**

1. Komisioni Statutar përbëhet prej Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe tre anëtarëve, të cilët i zgjedh Kuvendi i PEK-ut.

2. Mandati i Komisionit Statutar është 4 vjet.

3. Komisioni Statutar:

- *Interpreton Statutin dhe aktet e tjera të PEK-ut;*

- *Përgatit propozimin e ndryshimeve të Statutit, sipas vendimit të Këshillit të Përgjithshëm apo të Kryesisë së PEK-ut;*

- *Kujdeset për harmonizimin e vendimeve të PEK-ut me Statutin.*

#### **Neni 34**

Anëtarë të Komisionit Statutar nuk mund të jenë:

- *Anëtarët e Këshilli të Përgjithshëm;*

- *Anëtarët e Kryesisë së PEK-ut;*

- *Anëtarët e komisioneve të tjera të PEK-ut.*

**Sekretari i Përgjithshëm.**

---

## **Neni 35**

Sekretari i Përgjithshëm i PEK-ut:

- *Kujdeset për organizimin e punës së Kryesisë;*
- *Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit, të Këshillit të Përgjithshëm, të Kryetarit dhe të Kryesisë së PEK-ut, si dhe udhëheq shërbimet profesionale;*
- *Nënshkruan dokumentet operative financiare;*
- *Kujdeset për përdorimin e vulave për të gjitha nivelet organizative;*
- *Administron pasurinë në shfrytëzim;*
- *Përcjell pagesat e anëtarësisë dhe për këtë i raporton Kryesisë së PEK-ut;*
- *Nënshkruan kontrata;*
- *Organizon dhe bashkërendit punën e degëve të PEK-ut dhe për këtë i raporton Kryetarit dhe Kryesisë së PEK-ut;*
- *Kryen dhe punë të tjera, të cilat i parashtron Kryetari, Këshilli i Përgjithshëm dhe Kryesia e PEK-ut.*

## **Komisioni Mbikëqyrës**

### **Neni 36**

1. Komisioni Mbikëqyrës është trup Kontrollues-mbikëqyrës i PEK-ut, i cili zgjidhet për 4 vjet.
2. Komisioni Mbikëqyrës përbëhet prej 3 anëtarëve, të cilët i zgjedh Këshilli i Përgjithshëm i PEK-ut.
3. Komisioni Mbikëqyrës kontrollon të hyrat financiare të PEK-ut, shpërndarjen e tyre dhe menaxhimin me pronën në shfrytëzim të PEK-ut.
4. Komisioni Mbikëqyrës për kontrollin e brendshëm i raporton Këshillit të Përgjithshëm.

## **Komisioni Disiplinor**

### **Neni 37**

1. Komisioni Disiplinor përbëhet prej 3 anëtarëve.
2. Dy anëtarë i zgjedh Kryesia e PEK-ut, kurse një anëtar zgjidhet nga Kryesia e degës nga e cila trajtohet rasti.
3. Mënyra e funksionimit dhe fushëveprimi i Komisionit rregullohet me rregullore të veçantë.

## **Forumet, Këshillat dhe Grupet e Interesit të PEK-ut**

### **Neni 38**

---

1. Partia Euroatlantike e Kosovës vepron në fusha të caktuara nëpërmjet forumeve, këshillave dhe grupeve të interesit.
2. Forumet dhe këshillat e PEK-ut janë:
  - *Forumi i Gruas së PEK-ut;*
  - *Forumi Rinor i PEK-ut;*
  - *Forumi i Bizneseve i PEK-ut dhe*
  - *Këshilli i Ekspertëve i PEK-ut.*
3. Forumet e PEK-ut afirmojnë dhe realizojnë politikat e PEK-ut në fushat në të cilat veprojnë dhe u ndihmojnë organeve të PEK-ut për krijimin e politikave të qëndrueshme.
4. Në Forumin Rinor të PEK-ut organizohen të rinjtë nga moshën 16 deri në moshën 30 vjeçare.
5. Organizimi dhe zgjedhjet në forumet dhe këshillat e PEK-ut bëhet me rregullore të veçanta, të cilat miratohen nga Këshilli i Përgjithshëm i PEK-ut.
6. Forumi i bizneseve bashkon përfaqësuesit e bizneseve, përfshirë NVM-të, me qëllim të propozimit dhe promovimit të politikave zhvillimore dhe vijuese ekonomike.
7. Këshilli i Ekspertëve i PEK-ut përbëhet nga krijues shkencorë, arsimorë, kulturorë dhe profesionalë.
8. Këshilli i Ekspertëve i PEK-ut zhvillon dhe propozon programe, projekte dhe qëndrime politike për organet e PEK-ut, të cilat pasi të aprovohen nga këto organe bëhen qëndrime zyrtare të PEK-ut. Me aprovim të Kryetarit apo Kryesisë i adresohet opinionit.
9. Në kuadër të PEK-ut veprojnë grupet e interesit, si veteranët e luftës, invalidët, pensionistët dhe grupet e tjera.

## **Grupi Parlamentar**

### **Neni 39**

1. Grupin Parlamentar e përbëjnë përfaqësuesit e zgjedhur të PEK-ut në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
  2. Grupi Parlamentar:
    - *Implementon politikën e PEK-ut në Kuvendin e Republikës së Kosovës;*
    - *Shqyrton të gjitha çështjet parlamentare dhe iniciacionin e aktivitetit ligjvënës;*
    - *Bashkërendon marrjen e vendimeve në harmoni me politikat e PEK-ut të adresuara nga Kryetari dhe Kryesia.*
  3. Grupet e Këshilltarëve formohen në nivele të kuvendeve komunale.
-

4. Funksionimi i Grupit Parlamentar të PEK-ut dhe të Grupeve të Këshilltarëve në kuvendet komunale rregullohet me rregullore të veçantë.

### **Organizimi në nivel të degëve dhe të nëndegëve të PEK-ut**

#### **Neni 40**

1. PEK-u në terren organizohet në dy nivele, në:

- *Degë të PEK-ut dhe*
- *Nëndegë të PEK-ut.*

#### **Neni 41**

1. Degët dhe nëndegët e PEK-ut janë njësi të organizimit dhe të veprimit territorial të PEK-ut.
2. Degët e PEK-ut janë njësi të organizimit në nivel të komunës, sipas ndarjes territoriale administrative të Republikës së Kosovës.
3. Degët e PEK-ut mund të themelohen edhe nëpër vendbanime të caktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Përgjithshëm, me propozim të Kryesisë.
4. Prishtina ka disa degë të PEK-ut, bashkërenditjen e të cilave e bën Kolegjiumi i Degëve, pa të drejtë të marrjes së vendimeve.
5. Puna e Kolegjiumit të Degëve në Prishtinë rregullohet me rregullore të veçantë.
6. Degët mund të formohen edhe jashtë vendit, me propozim të Kryesisë dhe vendim të Këshillit të Përgjithshëm.
7. Degët e PEK-ut jashtë vendit e kanë kolegjiumin e tyre, të përbërë nga kryetarët e degëve, i cili e bashkërenditë punën e degëve, pa të drejtë të marrjes së vendimeve. Kryetari i Kolegjiumit të Degëve zgjidhet nga Kolegjiumi për një (1) vit.
8. Degët e PEK-ut jashtë vendit, krahas respektimit të Programit dhe Statutit të PEK-ut, duhet të respektojnë edhe legjislacionin e vendit përkatës.

#### **Neni 42**

1. Organet e Degës së PEK-ut janë:

- *Kuvendi;*

- *Kryetari dhe*

- *Kryesia e Degës.*

2. Kuvendin e Degës e përbëjnë delegatët, të zgjedhur në kuvendet e nëndegëve dhe përfaqësuesit e forumeve, nëse ato janë të organizuara.

3. Kuvendi i Degës së PEK-ut, në përputhje me Programin dhe Statutin e PEK-ut:

---

- Nxjerr Programin e Punës së Degës;
- Shqyrton dhe miraton Raportin e Punës së Kryesisë;
- Zgjedh Kryetarin e Degës dhe Kryesinë;
- Zgjedh delegatët për Kuvendin e PEK-ut;
- Merr vendime dhe qëndrime të tjera politike, në pajtim me Programin, Statutin e PEK-ut, vendimet e Këshillit të Përgjithshëm, të Kryetarit dhe të Kryesisë së PEK-ut.

4. Kuvendi i Degës së PEK-ut nuk mund të zgjedhë për delegatë në Kuvendin e PEK-ut anëtarin e PEK-ut, i cili ka hyrë më parë në procesin zgjedhor në ndonjë kuvend të ndonjë dege tjetër të PEK-ut, pa marrë parasysh rezultatin e votimit për të.

### **Neni 43**

1. Kuvendi Zgjedhor i Degës mbahet çdo 4 vjet dhe i paraprin Kuvendit Zgjedhor të PEK-ut.
2. Ndërmjet kuvendeve të rregullta zgjedhore, mbahen kuvendet e punës, së paku 1 herë.
3. Kuvendi i Degës thirret edhe atëherë kur këtë e kërkojnë 1/3 e delegatëve që e përbëjnë Kuvendin.

### **Kryetari i Degës**

#### **Neni 44**

1. Kryetari i Degës zgjidhet në Kuvendin e Degës, me votim të fshehtë, me më shumë kandidatë, të cilët jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre në komunën në të cilën është organizuar Dega.
  2. Kandidimi për kryetar bëhet në Kuvend të Degës. Kandidatura miratohet me 50 për qind plus 1 të delegatëve të pranishëm.
  3. Kryetari i Degës është kryetar i Kuvendit të Degës dhe i Kryesisë së Degës.
  4. Kryetari i Degës:
    - Përfaqëson degën në pajtim me Statutin dhe Programin e PEK-ut;
    - Thërret Kuvendin e Degës;
    - Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kryesisë së Degës;
    - Kujdeset për zbatimin vendimeve të Kuvendit të Degës;
    - Emëron udhëheqës të fushave të ndryshme të aktivitetit të PEK-ut;
    - I propozon Kuvendit kandidatët për anëtarë të Kryesisë, kurse Kuvendi ka të drejtë të shtojë edhe 1/3 e kandidatëve për Kryesi;
    - I propozon Kryesisë kandidatët për nënkryetar dhe sekretar të PEK-ut;
-

- *Bashkërendit punën me nëndegët;*
- *Kryen edhe punë të tjera, që dalin nga organet më të larta të PEK-ut.*

## **Kryesia e Degës**

### **Neni 45**

1. Kryesia e Degës është organ politiko-ekzekutiv i Kuvendit të Degës dhe përgjigjet për realizimin dhe zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Degës, si dhe të organeve më të larta të PEK-ut.
2. Numri i anëtarëve të Kryesisë së Degës përcaktohet me vendim të veçantë të Kryesisë së PEK-ut.
3. Anëtarë të Kryesisë së Degës janë edhe kryetarja e Forumit të Gruas dhe Kryetari i Forumit të Rinisë.
4. Kryesia e Degës:

- *Bashkërenditë punën e nëndegëve;*
- *Vendos për planin vjetor financiar të degës;*
- *Vendos për listën e kandidatëve për këshilltarë të Asamblesë Komunale;*
- *Propozon kandidatët për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga territori i saj;*
- *I propozon Kryesisë së PEK-ut (qendrore) kandidatët për kryetarë të komunave;*
- *Emëron komisionet funksionale, sipas nevojës;*
- *Me propozim të Kryetarit të Degës, zgjedh Nënkryetarin dhe Sekretarin e Degës;*
- *Nxjerr rregulloret në nivel të Degës, në harmoni me Statutin e PEK-ut;*
- *Bashkërenditë, përcjell, analizon dhe përkrah aktivitetin e nëndegëve në terren;*
- *Kujdeset për organizimin e zgjedhjeve partiake, zgjedhjeve lokale dhe të përgjithshme.*

## **Nëndega**

### **Neni 46**

1. Nëndega formohet në territorin e një apo më shumë fshatrave, respektivisht lagjeve të qytetit.
  2. Organet e nëndegës së PEK-ut janë Kuvendi dhe Kryesia.
  3. Kuvendi i Nëndegës zgjedh Kryetarin, Kryesinë e Nëndegës dhe delegatët për Kuvendin e Degës.
  4. Numri i delegatëve të Kuvendit të nëndegës caktohet varësisht prej numrit të anëtarëve të PEK-ut në nëndegë. Në të njëjtën mënyrë caktohet edhe numri i anëtarëve të Kryesisë së Nëndegës.
-



5. Përfaqësimi i nëndegëve në Kuvendin e Degës bëhet me vendim të Kryesisë së Degës, në bazë të kritereve të numrit të anëtarësisë.
6. Nëndega ka kryesinë e saj, e cila zbaton vendimet e degës dhe të organeve më të larta të PEK-ut.
7. Kryesia e Nëndegës zgjedh Nënkryetarin dhe Sekretarin e Kryesisë së Nëndegës.

#### **IV. ADMINISTRATA DHE FINANCAT**

##### **Neni 47**

##### **Administrata e PEK-ut**

##### **Neni 47**

1. Administrata e PEK-ut mbështet punën e organeve dhe trupave politike të PEK-ut.
2. Administrata e PEK-ut organizohet në sektorë dhe zyra të veçanta.
3. Administrata e PEK-ut udhëhiqet nga Drejtori i Administratës.
4. Sektorët dhe zyrat e PEK-ut janë:
  - *Spektori i Administratës së Përgjithshme dhe i Çështjeve Juridike;*
  - *Spektori i Financave, Buxhetit dhe Grumbullimit të Fondeve;*
  - *Spektori i Mbështetjes Profesionale;*
  - *Zyra e Protokollit dhe Marrëdhënieve me Jashtë;*
  - *Zyra për Marrëdhënie me Publikun, që përfshin edhe Qendrën për Informim të Kosovës.*
5. Administrata e PEK-ut:
  - U ofron mbështetje profesionale dhe teknike organeve të PEK-ut, Grupit Parlamentar të PEK-ut dhe Degëve të PEK-ut;
  - Publikon politikat, qëndrimet dhe strategjitë e PEK-ut në mediet vendore dhe ndërkombëtare, elektronike dhe të shkruara.
6. Drejtori i Administratës, udhëheqësit e sektorëve dhe të zyrave, për punën e tyre, i përgjigjen Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kryesisë.
7. Organizimi dhe funksionimi i Administratës së PEK-ut rregullohet me rregullore të veçantë.

##### **Financimi i PEK-ut**

##### **Neni 48**

---

1. Burimet e financimit të PEK-ut janë:

- *Burimet publike - mjetet nga Buxheti i Republikës së Kosovës;*

- *Burimet nga anëtarësia dhe donacionet e personave fizik dhe bizneseve, të hyrat nga aktivitetet promovuese të PEK-ut, botimet dhe nga prona e PEK-ut.*

2. PEK-u ka Zyrtarin Financiar, të cilin e emëron Kryetari dhe i përgjigjet drejtpërsëdrejti atij.

3. Zyrtari Financiar është përgjegjës për:

- *Përgatitjen dhe ekzekutimin e planeve financiare (buxhetit);*

- *Hartimin e raporteve financiare dhe raportimin para institucioneve të parapara me ligj.*

4. Këshilli i Përgjithshëm i PEK-ut, me propozim të Kryesisë, cakton lartësinë e pagesës së anëtarësisë për çdo vit kalendarik, si dhe destinimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve.

5. Kryesia e PEK-ut, çdo vit, cakton shumën e mjeteve të cilat u barten degëve, sipas kritereve të cilat rregullohen me rregullore të veçantë.

6. Për mjetet financiare të PEK-ut dhe shfrytëzimin e tyre, Kryesia i raporton Këshillit të Përgjithshëm çdo vit.

7. Partia Euroatlantike e Kosovës do t'i përmbahet Ligjit për Financimin e Partive Politike në Republikën e Kosovës, e cila do të posedoj edhe xhirrologarinë bankare, përmes të cilës kryhen të gjitha transaksionet.

## **V. MANDATI I ORGANEVE TË ZGJEDHURA, AKTET THEMELORE DHE KUSHTET NË TË CILAT PUSHON SË EKZISTUARI PEK-u**

### **Neni 49**

1. Mandati i anëtarëve të organeve të zgjedhura të PEK-ut është 4 (katër) vjet.

2. Shkarkimi i anëtarëve të zgjedhur të organeve të PEK-ut bëhet në të njëjtën mënyrë sikurse janë zgjedhur.

3. Anëtarët e organeve të zgjedhura të PEK-ut, të cilëve u grumbullohen më shumë pozita partiake apo partiake dhe parlamentare (qendrore ose lokale), duhet të tregojnë gatishmëri për t'u tërhequr nga pozitat, të cilat ata nuk mund t'i ushtrojnë siç e kërkon interesi i PEK-ut ose pozitat të cilat paraqesin konflikt interesi.

4. Nëse anëtarët e organeve të PEK-ut nuk paraqesin gatishmëri për të hequr dorë nga pozitat e shumëfishta, atëherë iniciativën e merr Kryetari i PEK-ut, kryetarët e degëve dhe kryesitë.

5. Çështja e posteve të shumëfishta dhe konflikti i interesit rregullohen me rregullore të veçantë.

### **Neni 50**

1. Akt themelor i Partisë Euroatlantike të Kosovës është Statuti i PEK-ut.

---

## **Neni 51**

1. PEK-u mund të pushojë së ekzistuari nëse për këtë vendosin  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e të gjithë delegatëve në mbledhjen e rregullt apo të jashtëzakonshme të Kuvendit të PEK-ut.

2. Me rastin e shuarjes nga paragrafi 1 i këtij neni, respektivisht në rast të shpërbërjes së PEK-ut, së pari përmbushen të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve, kurse pjesa e mjeteve të mbetura, me vendim të posaçëm të organit që merr vendim mbi shpërbërjen e PEK-ut, do të shpërndahen në organizata humanitare të vendit.

## **PROCEDURA E BASHKIMIT ME DY OSE ME SHUMË PARTI POLITIKE DHE SHKRIRJA NË NJË PARTI TJETËR POLITIKE**

## **Neni 52**

1. Bashkimi i PEK-ut me dy apo më shumë parti politike mund të bëhet pas marrjes së vendimit nga Kryetari i PEK-ut.

2. Vendimi sëbashku me procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura për bashkimin me dy apo më shumë parti politike i paraqiten zyres kompetente pranë KQZ-ës për regjistrim, të nënshkruar nga partia politike që merr pjesë në bashkim.

3. Shkrirja e PEK-ut në një parti tjetër politike bëhet, atëherë kur kuvendi i partisë ka vendosur që të shkrihet kjo parti politike në një parti tjetër politike, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

4. Kërkesa për shkrirje të partisë politike në një parti tjetër politike dhe çregjistrimin e saj, i dorëzohet zyres kompetente pranë KQZ-ës.

## **VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

## **Neni 53**

1. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës për nxjerrjen e tij.

2. Nismën për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit mund ta japë Kuvendi i PEK-ut, Këshilli i Përgjithshëm, Kryetari, Kryesia e PEK-ut dhe Komisioni Statutar.

3. Ndryshimet dhe plotësimet në organet e PEK-ut ndërmjet dy kuvendeve zgjedhore, të bazuara në Programin Politik të PEK-ut, mund të bëhen edhe me votim të hapur. Vendimi për votim të hapur merret me së paku 50 për qind plus një (1) votë të anëtarëve të organit përkatës.

## **Neni 54**

1. Interpretimin autentik të këtij Statuti e bën Kuvendi i PEK-ut.

2. Shpjegimet për zbatimin e dispozitave të këtij Statuti i jep Komisioni Statutar.

3. Tekstin e spastruar të Statutit dhe aktet e tjera të PEK-ut i ruan Sekretari i Përgjithshëm dhe Komisioni Statutar.

---

## **Neni 55**

1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i PEK-ut.
2. Të gjitha aktet e cekura në këtë Statut duhet të miratohen brenda periudhës prej 90 ditëve, pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

**Kryetari i PEK-ut**

**Milaim ZEKA**

---